

Partnerët influencojnë ndryshimin - kjo është rruga përpara

FAQE 2

Gratë ndërmarrëse ndërtojnë vizionin e tyre

FAQE 3

Gratë rurale në Kosovë krijojnë vende pune dhe jetë më të mirë

FAQE 4

2019  
DHJETOR

# Buletini.

PROMOVIMI I  
PUNËSIMIT NË  
SEKTORIN PRIVAT



Via Ferrata Panorama në Prizren, foto: Lis Dorambari

## Krijimi i përvojave të paharrueshme për turistët

Një përvojë brenda një destinacioni, pastaj një tjetër përvojë brenda të njëjtit destinacion e kështu me radhë deri në ditën e fundit të vizitës. Një udhëtim që shenjohej jo vetëm nga vendet e vizituara, ushqimi i shijuar, apo suveniret e blera, por një udhëtim i shenjuar nga përvojat, disa më risi, disa pak a shumë të njohura, por në një destinacion të ri. Këto janë përvojat që turisti merr me vete.

Në vitin 2019, shumë pronarë të produkteve turistike në Kosovë kanë ndërmarrë hapin e duhur për ta përmirësuar ofertën turistike të vendit me produkte të reja.

Si një destinacion me natyrë ngazëllyese, lista tashmë të larmishme e gjërave për të parë dhe bërë në Pejë është pasuruar më tej nga **Marimangat** me Via Ferrata 3 dhe një produkt turistik unik të turizmit në vend: Ura Tibetane, më e gjata e këtij lloji në Ballkan me gjatësi 41 metra dhe 60 metra lartësi. **Wander Adventures** ka sjellë një hostel

të ri dhe vend kampingu. Vendi i kampingut në Shtupeq të Madh nga **Camping LLC** në zemër të Grykës së Rugovës që po zhvillohet do të ofrojë shtëpiza prej druri luksoze, një zonë plazhi buzë lumit, kinema të hapur dhe më shumë

I njohur për trashëgiminë e pasur kulturore dhe historike, qyteti i DOKUFEST, Prizreni po shfaqet si një vend i ri për adhuruesit e adrenalinës. Me **Supercampers** ju mund të çikloni në mal apo të shkoni me kajake përgjatë lumenjve të zonës. Via Ferrata Panorama sapo iu bashkua listës së shtigjeve të tjera të ngjashme në Kosovë, produkt ky i menaxhuar nga **Shoqata e alpinistëve SHARRI**. Me pilotët e aeroklubit **SHK-ABA** mund të fluturoni me paragllajd mbi qytet për të shijuar një tjetër lloj të pamjes.

Në Prishtinë, me jetën e saj të gjallë të qytetit, kulturën e kafesë dhe monumentet nga periudha të ndryshme historike, sërisht mund të përjetoni adrenalinën duke bërë diçka ndryshe. **RAZ Es-**

**cape Room** është hapësirë e mbyllur pranë qendrës së qytetit, ku mund t'i jepni zgjidhje një misterit të madh. Nëse zgjidhni natyrën, shtegu në **Pyllin e Arinjve** të ofron shans për një shëtitje relaksuese teksa mësoni për speciet vendase dhe habitatin e tyre. Për të pasionuarit e mesjetës, në vitin 2020 ata mund të provojnë luftime me shpata dhe më shumë në parkun me temë mesjetare në Graçanicë, projekt ky i **Ordo Draconis**.

Duke shfrytëzuar dhuratat e natyrës dhe inovacionin njerëzor, viti 2019 u shenjua nga ide të shumëllojshme që u realizuan ose janë në rrugë e sipër për t'u shndërruar në përvojat e reja që vendi do t'u ofrojë turistëve në vitin 2020 për ta bërë udhëtimin e tyre në Kosovë të paharrueshëm. Këto produktet e reja janë rezultat i bashkëpunimit mes të gjithë palëve të interesit në sektorin privat dhe publik, me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ku secili ka luajtur një rol aktiv në zhvillimin e sektorit të turizmit!



# INFORMATA KRYESORE NGA PUNA JONË

## Partnerët influencojnë ndryshimin – kjo është rruga përpara

■“Çfarë ndodh kur kompanitë rrisin prodhimin, diversifikojnë produktet dhe përmirësojnë cilësinë? Ndër përfitimet e tjera, krijohen më shumë vende pune. Përmes aktiviteteve në sektorin e Ushqimit dhe Përbërësve Natyrorë, PPSE ka hyrë në partneritet me aktorë të sektorit të fokusuar tek inovacioni, rritja dhe qasja në tregjet e reja. Qëllimi është të ndikohet tek ndryshimet e qëndrueshme pozitive. Këta partnerë përfshijnë ndërmarrje eksportuese, qendra të grumbullimit, prodhuesi të vegjël dhe të mesëm dhe fermerët me përvojë, tregtarë të Inputeve bujqësore, ofruesi të shërbimeve të marketingut ose agjenci që mundësojnë lidhje tregtare.

Në përputhje me vizionin për t'u bërë udhëheqës në sektorin e përpunimit të bimëve mjekësore dhe aromatike, **ADE Group** ka hapur një fabrikë të re dhe moderne të përpunimit në zemër të Kosovës. Përmes partneritetit me PPSE-në, kompania ka siguruar një makinë korreze. Përveç kultivimit dhe mbledhjes së BMA-ve, ADE Group bashkëpunon ngushtë me fermerët duke iu ofruar atyre shërbime këshilluese, teknika të reja të kultivimit, inpute dhe u siguron tregun. Kompania së fundmi ka marrë certifikim organik.

Produktet e reja janë mënyra e sigurt për kompanitë që të ruajnë relevancën, të jenë konkurruese dhe të plotësojnë kërkesën e konsumatorit. **TP “N&N” Komerc**, që prodhon biskotat me mjaltë “Medenjak Pasha” ka blerë një linjë të re përpunimi përmes PPSE-së. Dy produktet e reja të kompanisë janë: çoko-biskota me mjaltë dhe biskota me glazurë mjalti. Do të krijohen të paktën 6 vende të reja pune për gratë rurale nga komunitetet pakicë. Partneriteti me **Kodra e Diellit** e plotëson listën e produkteve të tyre me produkte të reja me bazë frutash të thata dhe rolada e kekë të vegjël nga fru-



tat e thata. Ky ndryshim ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kompanisë, krijimin e vendeve të punës në nivel të ndërmarrjes dhe në depërtimin në tregjet rajonale dhe të BE-së.

Modeli i rritjes së fidanëve me cilësi të lartë në Kosovë po rritet edhe vetë! Në vitin 2018, aktiviteti ynë i përbashkët me **Fidanishten e Godancit**, serë për fidane të perimeve që nga viti 1993, u përqëndrua në përmirësimin e teknologjisë së prodhimit të fidanëve në serën ekzistuese. Në vitin 2019, PPSE nënshkroi fazën e dytë të bashkëpunimit me këtë biznes për ta avancuar edhe 0,1 ha si prodhues të specializuar të farave të perimeve. Meqenëse prodhimi i perimeve në Kosovë është një nga sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë, cilësia e fidanëve që prodhon Fidanishtja e Godancit është hap me rëndësi për rendiment

dhe cilësi më të lartë, që kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit të fermerëve për benefitet që sjell kjo metodë e prodhimit të fidanëve.

Një biznes në rritje duhet të ketë një brend që e tregon këtë energji rritjeje dhe i bën produktet e tij të dallohen. Partneri ynë **Natyra**, përpunues i uthullave dhe llojeve të ndryshme të çajit nga bimët mjekësore aromatike është në proces të rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimit të produkteve finale, përfshirë paketimin. Për prodhuesit si Natyra, PPSE ka mundësuar shërbime të marketingut që ndër të tjera, ndihmojnë kompanitë me brendet dhe nevojat e tyre të marketingut. Produktet e përmirësuara me paketim të përmirësuar do të jenë risi në tregun vendor.

Gjatë gjithë vitit 2019, partnerët tanë kanë influencuar ndryshimin dhe janë bërë ndryshimi vetë.







## Gratë ndërmarrëse ndërtojnë vizionin e tyre

■ Nëse hedhim sytë rrotull me qëllimin për të parë se ku janë gratë në sektorin privat, ato do t'i gjejmë si pronare biznesesh, si shefe ekzekutive, si menaxhere; do t'i gjejmë si udhërrëfyes malore për grupe të turistëve, duke grumbulluar bimë mjekësore aromatike, duke kultivuar perime, duke mbikëqyrur procese dhe duke u siguruar se bizneset veprojnë dhe duke fituar jetesën për familjet e tyre.

Por çfarë do të thotë të jesh grua ndërmarrëse? Cilat janë strategjitë e tyre në gjetjen ose krijimin e punësimit? Si mund të mendojnë ato në mënyrë krijuese, të rrjetëzohen dhe të sjellin qasje inovative? Çfarë e nxit vizionin e tyre?

Për të eksploruar disa nga këto pyetje dhe për të mësuar nga vetë gratë se çfarë u duhet atyre që të lulëzojnë në rolet që kanë zgjedhur, në nëntor 2019 PPSE-ja organizoi dy ngjarje të ndryshme që në total bënë bashkë mbi 70 gra ndërmarrëse dhe profesioniste nga sektorët e turizmit, përpunimit të ushqimit dhe gastronomisë, marketingut dhe TIK-ut.

Në punëtorinë e ditës së parë, gratë u përfshinë në një diskutim jashtë kornizave të zakonshme, u shkëmbyen ide mes grave nga fushat e përpunimit të ushqimit, turizmit, TIK-ut dhe marketingut. Ideja pas kësaj përzierjeje dhe formati ishte që pjesëmarrëseve t'u sigurohej hapësirë për të menduar në mënyrë kreative në përpjekje për të inkurajuar rrjetëzimin dhe qasjet inovative

për t'u përballur me sfidat, pengesat dhe për të menduar më qartë lidhur me hapat dhe vizionin e tyre të ardhshëm. Qëllimi ishte që vetë gratë të zbulonin se çfarë është bërë mirë dhe çfarë duhet ende të bëhet dhe ky informacion të përfshihet në aktivitetet e ardhshme të PPSE-së.

Dita e dytë ishte ngjarje rrjetëzuese, me dy synime kryesore. Së pari, u organizuan dy panele të grave lidere në fushat e tyre nga Kosova dhe Shqipëria për të diskutuar lidhur me rrugëtimin e tyre dhe rritjen e bizneseve të tyre, për rëndësinë e rrjetëzimit, mentorimit, aftësive drejtuese që duhet të zotërojnë gratë e shekullit 21, dhe se si gratë nga sektori privat dhe sektorët e tjerë mund të bashkohen në një rrjet të fortë për fuqizimin e tyre ekonomik. Diskutimet në panel u pasuan nga mundësitë për rrjetëzim midis pjesëmarrësve të audiencës (të gjitha gra ndërmarrëse) dhe panelisteve.

Projekti i Swisscontact-it në Kosovë Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) vepron në sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyrorë dhe turizmit. Aktivitetet e projektit synojnë që në mënyrë aktive të përfshijnë barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave në të gjitha aktivitetet e sektorit dhe në të gjitha nivelet. Në të vërtetë, mbi 40% e punësimit me kohë të plotë dhe njerëzit që kanë përfutur nga aktivitetet e projektit në vitin 2019 janë gra. PPSE synon të avancojë integrimin e grave përmes të gjitha aktivitetëve në të dy sektorët dhe t'i fuqizojë ato.



## A E KENI DITUR...?

A

...që brendimi, dizajni, marketingu dhe shërbimet e menaxhimit të mediave sociale mund të jenë kreative, profesionale dhe të përballeshme për kompanitë mikro dhe të vogla të përpunimit të ushqimit? Përmes marrëveshjes së partneritetit midis PPSE-së dhe United Pixels Academy, një grup i të rinjve kreative të sapodiplomuar nga akademja bashkëpunuan ngushtë me kompani të vogla të përpunimit të ushqimit për të përmirësuar brendimin dhe marketingun për produktet e reja finale të tyre. **Biofruti**, kompani që mbledh dhe përpunon bimë mjekësore dhe aromatike, tani ka brend modern të dizajnuar rishtazi përmes këtij partneriteti. Zarije Malsiu, pronare, tha se është shumë e kënaqur me shërbimin dhe produktin përfundimtar nga një prej dizajnerëve të rinj.

B

...se sektori i mikpritjes është thelbësor për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e destinacioneve? "Rrethi i impaktit" është mjet i dobishëm për pronarët dhe menaxherët e hoteleve që të kuptojnë ndikimin e veprimtarisë së tyre në bizneset, zonat, njerëzit përreth dhe, në një shkallë më të madhe, ekonominë. Ky mjet u shtjellua gjatë një punëtorie të organizuar nga Swisscontact për përfaqësuesit e industrisë së mikpritjes në Kosovë, ku pjesëmarrësit diskutuan se si ky informacion është thelbësor për përmirësimin e përvojës së vizitorëve dhe rritjen e tyre. "Unë do të marr masa për të rritur në mënyrë efektive ndikimin pozitiv të hotelit tonë në aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore" tha Rron Jupa, pronar i Hotelit Çarshia e Jupave.

C

...kuzhinieri Kurt Sheller erdhi në Kosovë përmes Korpusit të Ekspertëve Seniorë të Swisscontact-it, për të punuar direkt me kuzhinierët dhe menaxherët e restorantit Vila Park për të sjellë ndryshime të rëndësishme në menunë e tyre? Gjatë misionit dy-javor në Vila Park, kuzhinieri Sheller mbikëqyri nga afër aftësimin e një kuzhinieri të ri. "Në këto dy javë mësova shumë për gastronominë, gjëra të rëndësishme" tha Riza Çollaku, që ndoqi trajnimin. Ekspertët e KES po lënë gjurmë në të gjithë botën, kudo që ata udhëtojnë dhe shpërndajnë njohuri. [Klikoni këtu për të parë videon.](#)

D

...makineria e re e klasifikimit me lazer që Produktet Natyrale të Kosovës siguroi me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim i klasifikon llojet e farave të kungullit bazuar në madhësinë, formën, konsistencën dhe parametrat e tjerë të nevojshëm për të përbushur standardet ndërkombëtare të cilësisë? Përmes këtij bashkëinvestimi, vetëm në vitin 2018 PNK pati 6 punëtorë të rinj me kohë të plotë në fabrikë, 2 prej të cilëve gra; dhe angazhoi 12 punëtorë sezonalë shtesë për 8 muaj. "Unë kam një kontratë 4-vjeçare me kompaninë dhe tani për 4 vjet po kultivoj kunguj. Kjo më jep më shumë siguri në jetë" tha Drin Mula, një nga 45 fermerët me kontratë. [Klikoni këtu për të parë videon.](#)



## MODELI PËR NDRYSHIM

# Gratë rurale në Kosovë krijojnë vende pune dhe jetë më të mirë

Gjithëpërfshirja më e madhe e grave në zinxhirin e vlerave të ushqimit dhe përbërësve natyralë është një nga treguesit e rezultateve të PPSE-së. Në vitin 2018, të gjitha aktivitetet në këtë sektor kanë gjeneruar rreth 475 vende pune me kohë të plotë, prej të cilave 189 për gra dhe rreth 1,731 punësime të tjera fitimprurëse, prej të cilëve 676 për gra.

Afërdita Murati, është krenare për linjën e saj të produkteve nga manat e freskëta, si lëngje e reçel, dhe me të drejtë. Gjithçka nisi në vitin 2014, kur Afërdita pati rendiment shumë të lartë me mjedra nga 4 hektarët e tokës së saj dhe tepriçën e përdori për të bërë reçel mjedre për fëmijët e saj dhe lëng të freskët të aronias të shtrydhur me dorë. Tani, biznesi i saj shet produkte që sa vijnë e shtohen në mbi 500 shitore në të gjithë vendin.

Pasi ia nisi, Afërdita u bë pjesëmarrëse e rregullt në çdo panair ushqimor që mundej. “Nuk do kisha arritur asgjë pa kontaktet me të tjerë. Përveç idesë dhe gatishmërisë për biznes, rrjetëzimi është elementi që vyen për të arritur vizionin” është këshilla e Afërditës për çdo grua ndërmarrëse. Përveç biznesit, Afërdita themeloi edhe një OJQ për të nxitur rrjetëzimin ndërmjet grave në rajonin e saj dhe për t'i pajisur ato me shkathtësitë e

nevojshme për të fituar jetesën.

Në vitin 2017, Afërdita u zgjerua me kultivimin e aroniave dhe lëngu i freskët nga aroniat shitet për €15 liri. Teksa lista e klientëve rritej, ajo punësoi familjarët dhe gra të tjera nga fshati që të përballonte kërkesat.

Me përkrahjen e autoriteteve komunale dhe donatorëve, si Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, [Afërdita regjistroi biznesin e saj](#), bleu pajisjet e para dhe ndërtoi hapësirën prodhuese. Me përkrahje nga Swisscontact, ajo bleu makinerinë automatike për mbushje dhe mbyllje me kapak. “Duhej që 4 vetë të punonin gjithë ditën për të mbushur dhe mbyllur 500 shishe. Tani, me këtë makineri, procesi zgjat jo më shumë se 30 minuta” shprehet Afërdita që i gëzohet efikasitetit të procesit, i cili përkthehet në më shumë profit.

Sipas saj, përkrahja nga donatorët e sidomos për bizneset e grave, është kyçi për rritje.



Në kuadër të bashkëpunimit me Swisscontact, ajo do të zhvillojë brendin e ri për produktet e saj që sa vijnë e shtohen, do të patentojë recetat e saj dhe do të zhvillojë një plan të vërtetë të marketingut. Qëllimi i saj kryesor është të ruajë karakterin artizanial të produkteve të veta që e diferencojnë nga të tjerët dhe më pas, të nisë eksportin

[Klikoni këtu](#) që të lexoni storien e plotë të publikuar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale.



Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 |10000 Pristina, Kosovo  
Tel: +383(0)38220403  
email: [ppseinfo@swisscontact.org](mailto:ppseinfo@swisscontact.org)  
website: [www.ppse-kosovo.org](http://www.ppse-kosovo.org) and  
[www.swisscontact.org/kosovo](http://www.swisscontact.org/kosovo)  
[www.facebook.com/ppse.kosovo](https://www.facebook.com/ppse.kosovo)  
[https://twitter.com/PPSE\\_Kosovo](https://twitter.com/PPSE_Kosovo)  
<https://www.instagram.com/ppsekosovo/>

### Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.